

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR. 219 REP.
NR. 129 KOL
Notere Diana KAMBERI
Cel: 068 32 57 101.



KONTRATË SHITBLERJE
(Kuote Kapitali)

Sot më date 29.03.2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), para meje noteres publike, Diana KAMBERI, anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, në zyrën time noteriale të ndodhur në Tirane rruga "Mine Peza", u paraqitën personalisht palët kontraktuese të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate shitblerje kuote kapitali, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar) dhe statutin e shoqërisë "AESKULAP" SHPK, me kushtet e mëposhtme:

I PALËT

Pala Shitëse: EDVIN ZHUPA, i biri i Panajot. dhe Eli., i datëlindjes 30.01.1975, lindur në Sarandë dhe banues ne Sarande, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i panjohur prej meje noteres, mbajtës i letërnjoftimit numër 032657185 dhe numër personal H501300731, ortak i vetëm i shoqërisë "AESKULAP" SHPK.

Pala Blerëse: Z.VASIL LLAJO i biri i Spiros , i dt. 24.11.1956, lindur ne Sarande e banues ne Tirane , rruga "Ali Visha" me identitet leternjoftimin nr. Personal F61124099B ,madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar

Kushtet Paraprake

- Shoqëria "AESKULAP" SHPK, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është regjistruar si person juridik pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), më datë 19.11.2018, me Certifikatë Regjistrimit (NIPT) L823190060, me zyrë qendrore në Tiranë, rruga "Dritan Hoxha", ndërtesa 92, seksioni 4, h. 28, kati 0, me kapital të regjistruar 100,000 (njëqind mijë) lekë, me ortak të vetëm Edvin Zhupa, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 100,000 (njëqind mijë) lekë, e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë;
- Pala shitëse shpreh vullnetin për shitjen e kuotës që ai zotëron në shoqërinë "ASKULAP" SHPK dhe pala blerëse ka shprehur vullnetin për blerjen e kësaj kuote;

për sa më lart, palët në këtë kontratë, vendosin të lidhin këtë kontratë shitblerje kuote kapitali;

II OBJEKTI

2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse Edvin Zhupa, i shet palës blerëse Vasil Llajo, kuotën që ai zotëron në kapitalin e regjistruar të shoqërisë "ASKULAP" SHPK dhe që përbën 100% të kapitalit të kësaj shoqërie.

III CMIMI

3.1 Palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes në total të kuotavës që përbën 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "ASKULAP" SHPK të jetë 100 000 Leke (njeqind mije), shume e cila do të likuidohet me banke në llogarinë e noterit pranë Raifeisen Bank.

Kur pala blerëse të paguajë cmimin e kontratës në llogarinë e noterës, do të procedohet me regjistrimin e kontratës në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

3.3 Çmimi i kontratës do t'u kalohet palës shitëse, nga llogaria e noterës Noteres Diana Kamberi, në llogarinë e Shitesit, pasi kontrata të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe të jetë pasqyruar kalimi i kuotës, nga pala shitëse tek pala blerëse. Me likuidimin e vlerës prej 100 000 Leke, do të procedohet me regjistrimin e kontratës në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

IV KALIMI I PRONËSISË

4.1 Pronësia mbi kuotën e cila përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "ASKULAP" SHPK do të kalojë nga pala shitëse tek pala blerëse, pasi të jetë bërë pagimi i çmimit të kontratës, sipas nenit 3.2 të kësaj kontrate.

4.2 Kjo kontratë do të depozitohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), Tiranë së bashku me mandatin e pagesës së çmimit të kontratës, për efekt të kalimit të kuotës nga pala shitëse tek pala blerëse.

4.3 Nga momenti i depozitimit të kontratës në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pala shitëse humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotën e kapitalit të zotëruar në shoqërinë "ASKULAP" SHPK dhe këto të drejta fitohen nga pala blerëse Vasil LLAJO, i cili bëhet pronar i kësaj kuote.

Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) origjinale në gjuhën shqipe nga të cilat një qëndron në zyrën e noterisë, një depozitohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), një duhet të depozitohet në selinë e shoqërisë dhe nga një origjinal e merr secila palë e kësaj kontrate.

Kjo kontratë pasi iu lexua me zë të lartë palëve nga unë noteria, ata më deklaruan që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua prej tyre në praninë time dhe unë noteria e vërtetoj atë në bazë të ligjit.


PALA SHITËSE

EDVIN ZHUPA



PALA BLERËSE

VASIL LLAJO





Data : 01-04-2019

Dega: 022-Dega Bulevardi Zogu i I
Arka/Nr: TH1-0126
Veprimi: 20190401Irma.Hyka02254118
Ref: 20190401Irma.Hyka02254118

Depozitim Per te Trete

Urdhruesi : HAXHI ISLAM BAJRAKTARI

Perfituesi : DIANA KAMBERI PF K31603175F

Nr Llogarise : 0020721883

Komision ALL 275.00

Totali Ne Llogari : ALL 100,000.00

Shuma e Klientit : ALL 100,275.00

Kursi: 1.00

Pershkrimi i Veprimi : ALESKULAP SHIPKIDERIDI PER SHITJEAKSIONESH NE LLOG NGA HAXHI BAJRAKTARI

Sasia	Prerjet	Vlera	
20	5,000.00	100000.00	
2	100.00	200.00	
1	50.00	50.00	
1	20.00	20.00	
1	10.00	10.00	
1	5.00	-5.00	Kusur
Totali :		100,275.00	

Arketari

Irma.Hyka



Klienti

Haxhi Bajraktari

Rifreskoni kontaktet tuaja!

Nëse ndryshoni kontaktet tuaja (numër telefoni, adresë), vizitoni degën Raiffeisen më të afërt për ti rifreskuar ato. Vetëm duke patur numër telefoni dhe adresën tuaj të saktë, ne mund t'ju njoftojmë për çdo ofertë, produkt ose shërbim bankar. / In case you will change your contacts (mobile number, address), visit any Raiffeisen Bank branches to update them. Your new contacts allow us to inform you in real time on new offers, products and services, and other.

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-20190318124016914
Data e Rezultatit të Kërkimit: 18.03.2019
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 12:40:16PM
Lloji i Kërkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-089-252
Referenca e Përdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

AESKULAP SH.P.K.



Arta Shoku